



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 75/2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 155/2015, “PËR LOJËRAT E FATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pikat 1 e 2, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

Neni 1

Përpara nenit 1 shtohet një nen i ri me këtë përmbajtje:

“Neni 1

Përgjegjësia e shtetit

“Organizimi, zhvillimi dhe ndërmjetësimi i lojërave të fatit, basteve sportive dhe llotarisë është përgjegjësi e shtetit.”.

Neni 2

Neni 1 numërtohet neni 1/1.

Neni 3

Pas nenit 2 shtohet neni 2/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 2/1

Objektivat e ligjit

Ky ligj ka dhe këta objektiva:

1. Parandalimin e varësisë ndaj lojërave të fatit, basteve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për një luftë efektive kundër kësaj varësie.

2. Kontrollin e kësaj varësie në kanale të kufizuara, mbrojtura dhe supervizuara të lojërave të fatit, për të mos lejuar zhvillimin dhe përhapjen e tyre në mënyrë të paligjshme në tregun e zi.

3. Kundërveprimin për të siguruar të rinjtë dhe lojtarët.

4. Sigurimin që lojërat e fatit të kryhen në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe lojtarët të jenë të mbrojtur ndaj praktikave mashtruese të cilat lidhen me krimin.

5. Të parandalojë kërcënimet për integritetin e konkurrencës sportive nëpërmjet verifikimit të veprimtarisë së fiksimit të rezultateve sportive.

Për të arritur këto qëllime, janë vënë në dispozicion masa të ndryshme kufizuese ndaj aktivitetit të lojërave të fatit, varësisë, mashtrimit, manipulimit, kriminalitetit.”.

Neni 4

Në nenin 4, pika 13 riformulohet si më poshtë:

“13. “Hotele me 5 yje” janë hotelet, të cilat kanë marrë certifikatën e akreditimit për këtë klasifikim nga institucionet ndërkombëtare akredituese dhe që janë mbajtëse të një marke tregtare të regjistruar, të certifikuar dhe të njohur ndërkombëtarisht “*brand name*””.

Neni 5

Në nenin 9, pikat 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

“6. Ndalohen reklamat audiovizive për bastet sportive gjatë transmetimit të aktiviteteve sportive kombëtare dhe ndërkombëtare.

7. Ndalohet publiciteti në mediat e shkruara, në shtypin sportiv dhe në faqet sportive të mediave të tjera. Buletinet informative të organizatorëve nuk përbëjnë publicitet.”.

Neni 6

Në nenin 57 bëhet shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

1. Titulli i nenit bëhet “Bashkëpunimi me strukturat e tjera shtetërore”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Në rastet e konstatimit të shkeljeve, sipas dispozitave ndaluese të këtij ligji, me kërkesë të ministrisë përgjegjëse për financat, institucionet shtetërore përkatëse marrin masat e nevojshme për zbatimin e dispozitave të tij.”.

Neni 7

Në nenin 71 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Pas pikës 2 shtohen pikat 2/1 dhe 2/2 me këtë përmbajtje:

“2/1. Organizatorët e kategorive “baste sportive”, “baste për garat në pistë” dhe “lojërat elektronike në distancë” nga shoqëri vendase apo të huaja do të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në datën 31 dhjetor 2018.

Ndalohen të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë për kategoritë e sipërcituara. Të gjitha aplikimet në proces shqyrtimi, ndërpriten.

2/2. Pas datës 31 dhjetor 2018, asnjë shoqëri nuk mund të vendosë apo të ofrojë lojëra fati, sipas konceptit/funksionimit të VLT-së, përveç kategorive “kazino” dhe “resort kazino””.

2. Në pikën 3, fjalët “të kategorive” zëvendësohen me fjalët “të kategorisë”, ndërsa fjalët “basteve sportive” dhe “baste për garat në pistë” hiqen.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 25.10.2018